REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 100/17
Datë/Datum. 07.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(KK Kaçanik)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(KA 652 16 109 121)*

Sa i përket tenderit për *(Furnizim me material hargjues- administrativ për SHCK-ën, shkollat, zjarrfikësit dhe shëndetësinë, Kontratë njëvjeqare)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga."28Nëntori"no.121
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044974590 — */*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Astrit Uka- menagjer
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

infinittshpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

07.04.2017.
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

REPUBLIKA E KOSOVËS INFINITT SH.P.K. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____-_____

(Emri i avokatit)

_____-_____

(Adresa e plotë)

_____-_____ _____-_____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____-_____

(Adresa elektronike)

_____-_____ _____-_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë- 15.12. KRPP
Njoftimi për dhënie të kontratës – 19.01 KRPP
Afati i fundit për dorzimin e ofertave – 05.01. ora 14:00
Hapja e ofertave – 05.01. ora 14:30
Kriteri për dhënien e kontratës – Çmimi më i ulet
Kërkesa për ri-shqyrtim në AK- KK Kacanik – 23.01. vendimi i AK 26.01.
Ankesa OSHP – 02.02. – Vendimi i OSHP-së 10.03.

Vendimi i OSHP-se – 10.03.2017 (anulim i dhënies së kontratës- **RI-VLERESIM)**
Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm 24.03.2017. (letra standarde na është dërguar të premten me 24.03 ndërsa brenda në letër standarde është përshkruar data 22.03)
Njoftimi për dhënie në KRPP është shfaqur me 24.03. (në vend të njoftim per dhënie njoftimi në KRPP është shfaqur si njoftim për kontratë)
Kërkesa për ri-shqyrtim në AK-KK Kaçanik- 29.03. vendimi i AK 30.03

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

REPUBLIKA E KOSOVËS INFINITT SH.P.K. PRISHTINË

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e kemi pranuar me 24.03.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa për ri-shqyrtim në AK-KK Kaçanik- 29.03.
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim i AK- 30.03
(Shtojcë: VENDIMI I AK)

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 10- Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 23- Zyrtarët e Prokurimit
Neni 59 – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tendereve
Neni 61 – Tenderet jo normalisht të ulët, paragrafi 2- 2.1/2.2/2.3/2.4
Neni 112- Efekti pezullues i ankesave
Neni 131- Shkelja e ligjit nga Autoriteti Kontraktues

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

REPUBLIKA E KOSOVES INFINITT SH.P.K. PRISHTINË

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues KK Kaçanik përkatësisht komisioni vlersues nuk ka bër vlersimin e ofertave konform LPP. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nuk ka respektuar vendimin nr. 30-34/17 të lëshuar nga OSHP, ku decidivisht në fq 5 të vendimit, paragrafin 2 OSHP obligon Autoritetin kontraktues që vlersimin e çmimeve ta bëj konform nenit 61 të LPP dhe konform rregullave per tenderët jo-normalisht të ulët.

Sipas shkresave të cilat i kemi marë nga zyra e prokurimit gjatë qasjes në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktues me **16.03**. i ka dërguar operatorit "Rilindja" letër standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët dhe i është dhënë afat OE që të përgjigjet **brenda ditës** ndërsa OE "Rilindja" përgjigjen e ka kthyer me **20.03.** dmth me **4 ditë vonesë**, operatori është i obliguar që të kthejë përgjigje sipas afatit kohor të caktuar nga zyrtari kryesor i prokurimit në letër standarde.

Autoriteti kontraktues në letër standarde ka kërkuar nga operatori ekonomik "Rilindja" që të dërgojë shpjegime të detajishme konform LPP- Nenit 61- pika 2 për pozicionet: 6,20,33,37,38,109,129,154,155,163,165,171,174,184 në dosjen e tenderit pasiqë çmimet e ofruara nga OE për këto pozicione i ka cilësuar si jo-normalisht të ulëta dhe operatori përveq që ka derguar përgjigjen me **4 ditë vonesë** nuk është përgjigjur siq i është kërkuar në letër standarde dhe konform LPP- Nenit 61 pika 2, paragrafi 2.1/2.2/2.3/2.4 me dokumente, duke shpjeguar ekonominë e procesit te prodhimtarisë së produkteve, furnizimin e produkteve me fatura hyrëse apo dokumente të doganës, origjinalitetin e furnizimeve etj. Por ka dhënë një shpjegim se:

jemi të vetëdijshëm per cmimet e ofruara prandaj shpresojmë dhe besojmë që furnizimet do ti bejmë me kohë dhe sipas cmimeve perkatëse.

Poashtu nje tjetër arsye per këto cmime është se edhe gjatë hapjes së ofertave, thuajse të gjithë operatorët ekonomik kemi qenë të përafërt në vlerën e ofruar.

Kjo përgjigje nga OE nuk përkon me kërkesën e AK të derguar me 16.03. lidhur me pozicionet e lartëcekura, nuk janë dërguar informatat konform LPP-Nenit 61, Pika 2 dhe komisioni vlersues është dashur ti kërkojë zyrtarit kryesor të prokurimit që operatori ekonomik "Rilindja" të shpallet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga kjo procedurë e prokurimit, edhe sikur të dergoheshin sqarimet e nevojshme sipas LPP- Nenit 61, pika 2, prapë OE "Rilindja" duhej të shpallej si i papërgjegjshëm pasiqë sqarimet e nevojshme nuk i ka derguar brenda afatit ligjor të percaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

(shtojce letra standarde dhe pergjigja e OE)

Poashtu vlen të theksohet se AK ka devijuar dhe nuk ka respektuar LPP-Nenin 61 me rastin e dërgimit të letrës standarde per çmime jo normalisht të ulëta për OE- Rilindja pasiqë nuk i ka kërkuar sqarim të çmimeve edhe për shumë

REPUBLIKA E KOSOVËS INFINITT SH.P.K. PRISHTINË

pozicione ku OE ka ofertuar me çmime manipulative të cilat ne i kemi verifikuar gjatë qasjes në ofertën e OE, si në vijim : 3,4,5,42,43,44,94,117,118,121,128,137,138,144,145,147,148,149,150,152,153, 156,157,158,159,160,166,168,171,174,178,181,182,186. Edhe në këtë pikë vërehet shumë kjartë favorizim i AK ndaj OE Rilindja- Ferizaj.
(shtojce lista e çmimeve të OE-Rilindja)

Me 16.03 në ora 11:40 AK na ka derguar letër standarde per sqarimin e tenderit jo-normalisht të ulët dhe ne jemi pergjigjur brenda ditës sipas kërkesës në letrën standarde duke derguar sqarimet e nevojshme konform LPP- Nenit 61, pika 2, paragrafi 2.1/2.2/2.3/2.4
(shtojce korrespondencat me autoritetin kontraktues)

Gjatë zhvillimit të qasjes në ofertat e operatorëve ekonomik kemi hasur edhe në shumë parregullsi tjera dhe shkelje ligjore njëra prej të cilave që vlen të theksohet është se OE Rilindja, Stargraf dhe Promix iu ka skaduar validiteti i ofertës i kerkuar në dosjen e tenderit dhe automatikisht pasiqë OE e lartëcekur nuk kanë ofruar validitet shtesë është dashur të elimnohen si të papërgjegjshëm.

AK- KK Kaçanik poashtu ka shkelur Nenin 10 të LPP-së duke mos na ofruar qasjen në kohën kur ne kemi kërkuar me 24.03. kemi kërkuar dy herë qasje në ora 12:04 dhe 14:51, vetëm pas përsëritjes së kërkesës sonë të hënen me 27.03. ora 10:49 na është ofruar qasja e kërkuar. Kështu AK nuk ka përfillur Nenin 10 të LPP-së pasiqë e ka zvarritur kërkesën tonë në këtë mënyrë na ka shkurtuar afatin kohor për përgaditjen dhe parashtrimin e ankesës. Poashtu parregullësi tjetër që kemi vërejtur gjatë zhvillimit të qasjes është se shumë dokumente si lista e kontratave, certifikata e TVSH-së etj të OE- Rilindja të cilat i kemi kërkuar për verifikim nuk kanë qenë të bashkangjitura në dosjen e tenderit mirëpo zyrtari kryesor i prokurimit i ka mbajtur në zyren e tij dhe me kërkesën tonë i ka sjellur.
(shtojce korrespondencat me autoritetin kontraktues)

AK- KK Kaçanik poashtu ka shkelur Nenin 112 pasiqë nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e parashtrimit të ankesës nga ne as në herën e parë kur kemi parashtruar ankesë, as tani.

Favorizimi i AK- KK Kaçanik për OE- Rilindja është vërejtur edhe gjatë fazës së shqyrtimit të ankesës pasiqë AK i ka dhënë dy kontrata me vlerë minimale OE Rilindja me 14.03 Furnizim me tonerë dhe me 05.04. Furnizim me material administrativ, në formë të mbyllur pa hapur konkurencë për OE tjerë.

Prandaj duke u bazuar në faktet e lartëcekura kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit që ankesën tonë ta aprovojë si të bazuar, lenda të kthehet në ri-vlerësim dhe ne të shperblehemi me dhënie të kontratës si oferta më e

REPUBLIKA E KOSOVËS INFINITT SH.P.K. PRISHTINË

përgjegjshme, njëkohësisht kërkojmë nga organi shqyrtues i prokurimit të mer masa ndaj autoritetit kontraktues perkatësisht zyrtarit kryesor të prokurimit për mosrespektim të dispozitave ligjore dhe favorizim të OE të caktuar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të aprovojë ankesën tonë, të detyroj AK- KK Kaçanik që të bëjnë ri-vlersimin e ofertave drejtë, profesionalisht sipas ligjeve aktuale mbi prokurimin publik në fuqi dhe të jenë të paanshëm. Dhënia e kontratës për një operator ekonomik i cili nuk plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret në dosjen e tenderit përbën shkelje ligjore dhe rrezikon dëmtimin e buxhetit të Kosovës përkatësisht AK- KK Kacanik në këtë rast prandaj kërkojmë që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe tenderi të kthehet në ri-vlerësim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*